



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-26-1358 -1-2-1/C1138
14 Nr. 195/26
Dt. 23.04.2026

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Baki Automobile “sh.p.k**, emri i biznesit, me seli në **Prishtinë**, me ARBK : **810540402**, të cilën e përfaqëson **z. Avni Abdullahu** në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi – blerja e veturave**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	6	13	5	8	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	6	0	0	9	1	2	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi me 2 (dy) vetura për nevoja të Autoriteti Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë, në cilësi dhe përshtatshmëri në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: **jo më gjatë se 20 ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit të kontratës.**

1.3 Vendi i **dërgimit – pranimit të veturave do të jetë : autoparkingu i Furnizuesit**, në pajtim me **Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.**

1.4 Incotermit i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **90,000.00€ (nëntdhjetë mij/00 Euro).**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës **pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit (automjeteve) i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim- dorëzimin e automjeteve, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se automjetet dhe pajisjet tjera përcjellëse janë dorëzuar – pranuar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit teknik të mallit, si në aspektin sasior, të përshtatshmërisë, ashtu dhe në aspektin cilësor, respektivisht konform specifikave teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit.**

Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve dhe / ose shërbimeve** është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit është **përgjegjësi e furnizuesit. Kontraktuesi - Furnizuesi duhet të ofroj Deklaratë me shkrim në formën origjinale mbi garancionin e sigurimit të kualitetit në kohëzgjatje prej së paku 24 muajve nga data e pranimit të mallit (automjeteve) të saktësuara si në Dosjen e Tenderit – pjesa : Përshkrimi i pozicioneve dhe çmimet si dhe sipas kushteve të saktësuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës.**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **furnizimeve dhe / ose shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti, në pajtim me ligjin e Kosovës.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogjaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoriteti Kontraktues:

Komuna Vushtrri

Për Operatori Ekonomik :

“ Baki Automobile “sh.p.k. – Prishtinë

Emri:	<i>Ilmi Azemi</i>	Emri:	<i>Avni Abdullahu</i>
Pozita:	<i>Drejtor</i>	Pozita:	<i>Drejtor</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<i>23.04.2026</i>	Data:	<i>23.04.2026</i>
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 197/26
Dt. 23.04.2026.

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 pika 14 të Statutit të Komunës Vushtrri, nenit 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 70 paragrafi 70.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njërive Kërkuese, më dt. 23.04.2026 merë:

V E N D I M

1. Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **'' Blerja e veturave''**, me numër të prokurimit: **VU644-26-1358-1-2-1** dhe numër të brendshëm të prokurimit **VU644-26-009-1-2-1**, si vijon:

z.Arben Basholli, emërohet menaxher i kontratës, që përfaqëson Drejtorinë për Shërbime Publike

z.Benjamin Shala, emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë Menaxherit të Kontratës, që përfaqëson Drejtorinë për Shërbime Publike, si njësi kërkuese.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / mobilizimi i kontratës". Plan i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim me Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do të lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të

kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon:

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësime të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

3. Për Komision të Pranimit të mallit të porositur dhe të furnizuar sipas projektit : **'' Blerja e veturave''**, me numër të prokurimit: **VU644-26-1358-1-2-1** dhe numër të brendshëm të prokurimit **VU644-26-009-1-2-1**, emëroi:

1. z. Luan Basholli– kryesues
2. z. Shkelzen Osmani– anëtar
3. z. Burim Rexhepi – anëtar

4. Komisioni, si në nenin 3 të këtij Vendimi, secili për pjesën e tij të përgjegjësisë, ka për detyrë të bëjë kontrollin cilësorë dhe sasiore të furnizimeve dhe / ose shërbimeve sipas Kërkesës – Porosisë për blerje të Njësisë Kërkuese të cilën e përfaqëson, si dhe pranimin e mallit të dorëzuar, ku kryes i furnizimeve për materialin sipas përshkrimit **'' Blerja e veturave''**, me numër të prokurimit: **VU644-26-1358-1-2-1** dhe numër të brendshëm të prokurimit **VU644-26-009-1-2-1**, është OE.: „Baki Automobile” SH.P.K., Vëllezërit Fazliu, -, PRISHTINË, Kosovë, të cilën e përfaqëson z. Anita Abdullahu në bazë të kontratës, nr. 195/26 datë 23.04.2026.

5. Komisioni do të filloi me punë me të pranuar të këtij Aktvendimi ndërsa do të bashkëpunoi ngushtë, në çdo kohë, me Menaxherin e Kontratës të Njësisë Shpenzuese gjegjëse si dhe Menaxherin e Kontratës të Kontraktuesit.

6. Nëse Komisioni konstaton të meta dhe/ ose parregullësi në cilësinë ose përshtatshmërinë e mallit të dorëzuar, atëherë Komisioni do të caktoj afatin për mënjanimin e parregullsive dhe / ose mangësive të konstatuara dhe të pranoi mallin pas mënjimit të mangësive të konstatuara.

7. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë do të hartoi **Raport në të cili do të konfirmoi** përfundimin e furnizimeve të Porositura , të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t’ia dërgoi, një kopje Kryesit të furnizimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm.

8. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – **Komunës së Vushtrrisë dhe Operatori Ekonomik : „Baki Automobile” SH.P.K., Vëllezërit Fazliu, -, PRISHTINË, Kosovë**


Kopje: 1 x 1 Menaxheri i Kontratës;

1 x 1 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;

1 x 1 Komisionit të pranimit të mallit;

1 x 1 Drejtorisë së Prokurimit.

Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës



SCARDIAN

SIGURIME

0055614

055614

NUMRI I POLICËS

K.S. SCARDIAN J.S.C
Adresa:
Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine,
Kosovo

SIGURUESI

Anita Abdullahu
Adresa:
rr. Vllezerit Fazliu

AGJENTI

BAKI AUTOMOBILE SH.P.K
Adresa:
RR.V.FAZLIU PN

I SIGURUARI

810540402

NUMRI I BIZNESIT

600011811

NUMRI FISKAL

Garanci e Kontratës

QËLLIMI I SIGURIMIT

KOMUNA E VUSHTRRISË

PËRFITUESI

BLERJA E VETURAVE

TITULLI I KONTRATËS

644-26-1358-1-2-1

NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT

Republika e Kosovës

TERRITORI I MBULIMIT

61 ditë

PERIUDHA E SIGURIMIT

9,000.00 EURO

SHUMA E SIGURUAR

23-04-2026

Nga:

23-06-2026

Deri:

162.00

PRIMI I SIGURIMIT

29.16

TVSH 18 %

191.16

PRIMI +TVSH 18%

2026-04-22 14:23:25

DATA E LËSHIMIT

VËREJTJE: NR I BRENDSEHEM : 644-26-009-1-2-1

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruarit/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruarit/ përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

Anita Abdullahu
(emri, mbiemri, nënshkrimi)

SCARDIAN

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



Pjesë përbërëse e policës: 055614

Për: KOMUNA E VUSHTRRIË
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: BAKI AUTOMOBILE SH.P.K, RR.V.FAZLIU PN
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: NR I BREND SHEM : 644-26-009-1-2-1

Titulli i aktivitetit të prokurimit: BLERJA E VETURAVE
Numri i prokurimit: 644-26-1358-1-2-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **9,000.00 EURO (NENTE MIJE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **9,000.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen 61 ditë
Data e fillimit: 23-04-2026

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2026-04-22 14:23:25



tëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në ashtu ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore.

	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
ne	copë	1	25,423.73	18.00	30,000.00	25,423.73	4,576.27	30,000.00
fikimeve	copë	1	50,847.46	18.00	60,000.00	50,847.46	9,152.54	60,000.00
						76,271.19	13,728.81	90,000.00

NTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
	Baki Automobile SH.P.K
TE	Avni Abdullahu
	08.04.2026



AUTORITETI KONTRAKTUES

KOMUNA E VUSHTRISË, SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173, 42000, VUSHTRRI,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 644-26-1358-1-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: „Baki Automobile” SH.P.K., Vëllezërit Fazliu, -, PRISHTINË, Kosovë

E-mail: anita.abdullahu@baki-vw.eu

Personi kontaktues: Avni Abdullahu

Telefoni: +383 45956555

Faxi: N/A

Numri fiskal: 600011811

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):